



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



# Perceptimi qytetar mbi cilësinë e shërbimeve publike në Bashkinë Pukë

Realizuar nga grupi qytetar BORIA

në kuadër të projektit:

## BORIA

**B**ashkëpunimi dhe **O**rganizimi për **R**ritjen e **I**nsiativave dhe **A**ktivizmit

Pukë, Prill 2017

Projekti BORIA zbatohet nga **Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen"** - Pukë, në kuadër të programit PACT - Partneritet në luftën kundër korrupsionit, të financuar nga **Bashkimi Evropian në Shqipëri** dhe të zbatuar nga **Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike (ANTTARC)** në partneritet me **Fondacionin Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF)** dhe **Qendrën Vepro për Shoqërinë (Aff)**



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



## Përmbajtja

Përmbledhje .....	3
Dy fjalë për projektin .....	3
Hartëzimi paraprak.....	4
Metodologjia e përfshirjes qytetare .....	8
Sondazhi qytetar i realizuar nga Grupet “BORIA” .....	9
Të dhëna nga sondazhi:.....	11
PËRFUNDIME / GJETJE DHE REKOMANDIME .....	18



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



## Përmbledhje

Ky dokument përmbledh gjetje dhe rekomandime qytetare, nxjerrë nga sondazhi i realizuar nga grupi qytetar Boria mbi perceptimin qytetar për cilësinë dhe aksesin në shërbimet publike, të cilat janë validuar dhe pasuruar më tej gjatë takimeve komunitare të zhvilluara në të gjitha zonat e përfshira në sondazh, si dhe janë prezantuar Bashkisë Pukë dhe 4 Njësi Administrative përkatëse në takimet e zhvilluara.

Gjatë këtij sondazhi të kryer nga grupi qytetar BORIA, 200 qytetarë kanë dhënë mendimin e tyre mbi situatën ekzistuese dhe rekomandime për përmirësimin e shërbimeve publike në mbulim, standard dhe cilësi, në rritjen e bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe qytetarëve si dhe në mbështetje për planifikimin e shërbimeve nga ana e autoriteteve lokale.

Kjo nismë është realizuar në kuadër të projektit “BORIA – Bashkëpunimi dhe Organizimi për Rritjen e Inisiativave dhe Aktivizimit” të zbatuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” nën programin PACT, të zbatuar nga ANNTARC me mbështetje të Bashkimit Europian.

## Dy fjalë për projektin

Projektit “BORIA – Bashkëpunimi dhe Organizimi për Rritjen e Inisiativave dhe Aktivizimit” i zbatuar nga Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” nën programin PACT, të zbatuar nga ANNTARC me mbështetje të Bashkimit Europian, është i fokusuar në **fushën e qeverisjes së mirë** në bashkinë Pukë, që mbulon **Qytetin Pukë dhe njësitë administrative Luf-Qerret, Qelëz, Gjegjan dhe Rrape**, nëpërmjet rritjes së angazhimit të qytetarëve në përmirësimin e shërbimeve publike në mbulim, standard dhe cilësi, rritjes së bashkëpunimit midis autoriteteve lokale dhe qytetarëve, si dhe mbështetjes në planifikimin e shërbimeve nga ana e autoriteteve lokale.



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



Konkretisht, Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” nëpërmjet këtij projekti ka nxitur angazhimin qytetar duke mundësuar krijimin e grupeve qytetare të quajtur BORIA; njohjen e tyre me institucionet dhe autoritetet vendore, me funksionimin dhe me rolin e tyre si vëzhgues dhe raportues qytetarë dhe me ndërmarrjen e aksioneve qytetare si: sondazhe në terren për tematika, të cilat prekin cilësinë e jetës së tyre dhe se si të adresojnë dhe të organizojnë sesione diskutimi dhe bashkëpunimi me institucionet dhe autoritetet vendore, të ndërmarrin hartëzim, nxjerrje nevojash dhe dhënie rekomandimesh për përmirësimin e planeve lokale dhe për planifikim sa më të mirë të fondeve publike.

## Hartëzimi paraprak

Zhvillimet e fundit politike në Shqipëri, kanë krijuar mundësi për rikonsiderimin dhe përmirësimin e politikave publike mbi adresimin e çështjeve kryesore si dhuna, papunësia, arsimi, shërbimet publike etj., ndërkohë që Reforma Territoriale trajton konsolidimin administrativ dhe midis të tjerave dhe rritjen e aftësisë për të ofruar një gamë më të madhe shërbimesh me cilësi më të lartë dhe me kosto administrative më të ulët.

Bashkia Pukë është një zonë malore, me papunësi, varfëri dhe probleme sociale të mëdha. Përveç problemeve të mbartura, bashkia ka vuajtur mungesën e investimeve dhe hapjen e vendeve të punës. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Puka, Gjeggjani, Rrape, Qelëz dhe Qerret. Qyteti i Pukës është pikë ndërveprimi për të gjithë institucionet e NJQV-ve përbërëse të bashkisë Pukë. Kjo ndikon në aksesin e shërbimeve për zona të ndryshme të Bashkisë Pukë. Transporti mbetet privat dhe shërbimi nuk ofrohet njësoj apo me të njëjtën frekuencë nga të gjitha zonat, gjë që e bën të vështirë aksesin e banorëve të fshatrave në shërbimet publike të Njësisve Administrative apo në Pukë. Sidomos fshatrat e largëta kanë vështirësi të mëdha për të



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



raportuar problemet e tyre apo për të marrë shërbim në qytetin e Pukës për shkak se infrastruktura në këto territore e vështirëson këtë problem.

Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11,069 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 16,836 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505.53 km<sup>2</sup> me një densitet prej 33.30 banorë/km<sup>2</sup> sipas Regjistrimit Civil dhe 21.89 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011. Jeta e qytetarëve të Pukës nuk paraqitet e lehtë, dhe kjo vërhet nga trendi i tkurrjes së numrit të popullsisë nga viti në vit, të cilët po braktisin zonën për shkak të mungesës së mundësive. Shkalla e lartë e emigrimit, papunësia, mungesa e vendeve të punës, mungesa e shërbimeve sidomos sociale, niveli i ulët arsimor, mungesat në infrastrukturë ndikojnë në nxitjen dhe rritjen e fenomenit të dhunës në familje, disintegrimit social, sidomos të të rinjve, rritjen e përdorimit të lëndëve narkotike dhe përfshirjen në situata kriminale.

Me këto problematika është e vështirë të sigurohen shërbime cilësore publike pa angazhimin e gjithë aktorëve dhe institucioneve të referencës dhe sidomos pa dëgjuar zërin e qytetarëve.

Me strategjinë e re vendore, Bashkia Pukë ka parashikuar investime në sektorin e turizmit dhe në infrastrukturë për të rritur nivelin ekonomik të zonës. Megjithatë, potencialet e saj për të zhvilluar turizmin si një sektor puthuajse të vetëm për zhvillimin e vendit, zbehen nga izolimi gjeografik si pasojë e aneksimit të zonës nga akset kryesore të transportit rrugor, veçanërisht nga Rruga e Kombit.

Megjithë planet për investime në infrastrukturë dhe për institucionet që ofrojnë shërbime publike, shërbimet publike në Bashkinë Pukë janë të limituara në numër dhe në cilësi. Ajo që shihet tepër e nevojshme është që krahas investimeve në infrastrukturën e institucioneve të shërbimeve publike, të punohet për rritjen e nivelit të shërbimit të ofruar në cilësi, numër, shpërndarje, standard etj., duke u mbështetur nga qytetarët nëpërmjet përfshirjes dhe angazhimit të grupeve komunitare watchdog "Boria".



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



Si institucione publike, bashkia Pukë ofron:

**Në sektorin e arsimit:** 2 kopshte, 1 shkollë nëntëvjeçare dhe 1 shkollë të mesme në qytet, si dhe konviktin e shkollës së mesme me kapacitet rreth 100 nxënës nga fshatrat përreth. Gjithashtu Gjegjan dhe Qelëzi kanë një shkollë të bashkuar (nëntëvjeçare dhe të mesme) ku ofrohen dhe disa klase parashkollori, por nuk kanë kopsht. Ndërkohë që Rrape dhe Luf-Qerret kanë vetëm një shkollë nëntëvjeçare. Ndërsa Drejtoria Arsimore e Pukës merret me pjesën mësimore, infrastruktura e shkollave dhe kopshteve, si dhe konvikti janë nën autoritetin e bashkisë. Cilësia e shërbimit dhe infrastruktura janë dy elemente që do të merren në konsideratë nga projekti.

**Në sektorin e shëndetësisë:** 1 spital (urgjencë, maternitet, specialitetete) dhe një qendër shëndetësore në qytet, si dhe nga një qendër shëndetësore në njësitë administrative. Në qytet është e vendosur dhe Drejtoria e Shëndetit Publik që mbulon dhënien e shërbimit shëndetësor. Së pari, shërbimi i ambulancës, aksesit në qendrat shëndetësore, cilësia e shërbimit, si dhe nevoja për shërbime të tjera shtesë do të jenë në konsideratë nga projekti.

**Në sektorin social:** Vetëm qyteti i Pukës ka një Kinema jashtë funksionit, e cila është në plan për t'u rikonstruktuar; ka Pallatin e Kulturës që organizon aktivitete me rastin e festave, por nuk ofron shërbim periodik; ka një qendër kulturore për fëmijët që mobilizon një grup fëmijësh në valle dhe këngë. Potencialet e tyre janë të paeksploruara dhe krahas investimeve publike, kërkohet dhe përcaktim i nevojave për zgjerim të shërbimit, rritje të aktiviteteve sociale dhe cilësisë së tyre konform resurseve tradicionale dhe talenteve në vend.

Përveç këtyre shërbimeve nën funksionin e Bashkisë Pukë, edhe shërbimet e tjera, si shërbimi për PAK (personave me aftësi të kufizuar), shërbimet e përfshirjes sociale janë të limituara në kapacitete të burimeve njerëzore, infrastrukturore dhe buxhetore. Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve nuk është në strukturën e bashkisë, kurse shërbimet për trajtimin e rasteve të dhunës në familje janë të limituara vetëm në adresim. Qendra



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



Komunitare “Sot për të Ardhmen” gjatë 9 viteve të funksionimit të saj ka komplementuar pothuajse gjithë rangun e shërbimeve sociale dhe kulturore jo vetëm për qytetin e Pukës, por për të gjithë zonën e bashkisë, duke ofruar shërbime të drejtpërdrejta si: kopsht, program parashkollor, program social dhe shërbim shëndetësor bazik për të moshuarit, programe edukuese, zhvilluese, ndërgjegjësimi për gratë, fëmijët dhe të rinjtë, kinema e aktivitete kulturore, shërbim psikologjik dhe këshillues për gratë dhe vajzat dhe rastet e dhunës në familje, shërbim gjinekologjik për gratë dhe shërbim karriere dhe formim profesional për të rinjtë në fushën e turizmit. Të gjitha këto shërbime janë ose të limituara në varietet, numër, cilësi dhe shpërndarje ose mungojnë.

**Në sektorin e punësimit:** në qytetin e Pukës ndodhet zyra e punës që merret me programet e asistencës, papunësisë dhe nxitjes së punësimit, Drejtoria e Pyjeve; në bashki janë sektorët e turizmit megjithatë, pak është bërë për nxitjen e sektorit privat në partneritet me autoritetet për të nxitur punësimin në ato sektorë që kanë potenciale siç është turizmi, përpunimi dhe pyjet. Gjithashtu, një lidhje më e mirë midis gjendjes civile dhe zyrës së punës duhet të jetë në identifikimin e forcës së re aktive për punë. Me planet e reja për zhvillimin e turizmit dhe nxitjen e partneritetit publik – privat, projekti me përfshirjen qytetare që synon, është një shërbim i madh në terren për bashkinë Pukë në hartëzimin e potencialeve vendore.

**Sektori i mjedisit** është në fokus të investimeve nga Bashkia në mirëmbajtje të rrugëve, pastrim, gjelbërim dhe vendosje të koshave për largimin e mbetjeve urbane, por shtrirja e kësaj nisme duhet të jetë e unifikuar në të gjithë territorin e bashkisë.



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



## Metodologjia e përfshirjes qytetare

Si metodologji është përdorur kombinimi i të gjithë grupeve të synuara dhe përfituesve, si dhe kombinimi i perceptimit qytetar me prioritetet e Bashkisë Pukë. Për aktivizim qytetar sa më të madh, metodologjia është fokusuar në përfshirjen horizontale të qytetarëve (pra arritjen e një numri të madh njerëzish të pyetur, rreth 200) dhe në përfshirjen vertikale të qytetarëve nëpërmjet dy shkallëve: diskutimet komunitare (rreth 100 qytetarë) dhe angazhimit në terren dhe inisiativës qytetare (grupimi watchdog “Boria”)

Duke qenë se synimi i projektit është përfshirja qytetarë në ndërmarrjen e nismave në mirëqeverisje, metodologjia e përdorur ka synuar:

Së pari, krijimin e grupimit komunitar watchdog “Boria” të cilët kanë shprehur aktivizmin e tyre qytetar për të qenë ndërlidhës komunitarë në përcjelljen e zërit qytetar te pushteti vendor.

Së dyti, ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të grupeve Boria që të kryejnë sa më mirë këtë rol. Këtu përfshihen: informim mbi kuadrin e legjislacionit të pushtetit vendor, njohje me institucionet publike dhe funksionet e tyre, etj, si dhe trajnim mbi realizimin e sondazheve qytetare, mbledhjen dhe filtrimin e të dhënave, nxjerrjen e rekomandimeve, si dhe adresimin e tyre në institucionet përkatëse.

Pas realizimit të ngritjes së kapaciteteve të grupeve Boria, ata janë vendosur në terren dhe kanë realizuar sondazhin qytetar me një kampion prej 200 qytetarësh nga qyteti i Pukës dhe 4 Njësitë Administrative.

Në vijim të realizimit të sondazhit dhe mbledhjes së të dhënave, Grupet Boria me Qendrën për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” Pukë kanë organizuar takime komunitare me rreth 100 qytetarë për informim dhe diskutim mbi gjetjet e sondazhit dhe formulimit të rekomandimeve. Gjatë këtyre takimeve qytetarët kanë validuar si rezultatet e sondazhit, ashtu dhe rekomandimet përkatëse.





BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



Metodologjia gjithashtu ka targetuar, përveç përfshirjes qytetare në nisma civile, dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre për të adresuar, raportuar dhe diskutuar me institucionet publike referente mbi tematika qytetare, duke mundësuar dhe ndërmjetësuar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Bashkisë Pukë dhe 4 Njësive Administrative në takimet komunitare për të diskutar së bashku dhe drejtpërdrejtë rekomandimet mbi mirëqeverisjen.

Metodologjia në këtë formë është e thjeshtë, gjithëpërfshirëse dhe mbulon të gjitha etapat e një procesi të llogjikshëm, që jep rezultat dhe që çon përpara zhvillimin.

## Sondazhi qytetar i realizuar nga Grupet “BORIA”

### Të dhëna mbi sondazhin:

- **Sondazhi u realizua nga anëtarët e Grupit Boria:**
  - 25 qytetarë të grupmoshave të ndryshëm mbi 17 vjeç, aktivë dhe disponibël për të bërë vlerësimin në terren të shërbimeve publike.
- **Institucionet në sondazh:**
  - Bashkia Pukë + 4 njësi administrative
  - Institucione publike: Drejtoria Arsimore, Drejtoria Shëndetit Publik, Zyra e Punës, Zyra e Gjendjes Civile
- **Shërbimet publike në sondazh janë:**
  - Shërbimet e Bashkisë Pukë
  - Shërbimet e Njesisë Administrative Gjegjan
  - Shërbimet e Njesisë Administrative Luf Qerret
  - Shërbimet e Njesisë Administrative Qelëz
  - Shërbimet e Njesisë Administrative Rrape
  - Shërbimi publik në sektorin e Arsimit
  - Shërbimi publik në sektorin e shëndetësisë



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



- Shërbimi publik i ofruar nga Zyra e Punës
- Shërbimi publik i ofruar nga Gjendja civile
- Shërbimi i Transportit
- **Të intervistuar (200 qytetarë):**
  - 50 të intervistuar në Pukë
  - 25 të intervistuar në Njësinë Administrative Gjegjan
  - 25 të intervistuar në Njësinë Administrative Luf Qerret
  - 25 të intervistuar në Njësinë Administrative Qelëz
  - 25 të intervistuar në Njësinë Administrative Rrape
- **Parimet dhe kuadri ligjor mbi të cilën është realizuar sondazhi nga grupet BORIA:**
  - Transparenca
  - Mirëqeverisja
  - Barazia
  - Kushtetuta e Shqipërisë - Nenin 23
  - Ligji nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare” - Kreun 2/ neni 3
  - Ligji nr.8485, datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” - Neni 1; 20; 51
  - Ligji Nr.8652, dt.31.07.2000 për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore
  - Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”
  - Ligji nr.10 129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”
  - Plani i Zhvillimit strategjik i Bashkisë Pukë



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI




## Të dhëna nga sondazhi:



### Aksesi i shërbimeve publike

Sipas sondazhit qytetar, përdorimi i shërbimeve publike është në nivelin: shëndetësia 94%, gjendja civile 92%, arsimi 83%, zyra e punës 74%, NJQV 74% dhe bashkia 88%





BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



- Zonat rurale përdorin më pak shërbimet publike se sa zonat urbane (mesatarisht rreth **10% më pak**), dhe kryesisht të lidhura me tokën, ndihmën ekonomike dhe gjendjen civile.
- Shëndetsia është shërbimi publik më pak i përdorur nga zonat rurale se sa urbane, rreth **20% më pak**.



Zonat rurale përdorin **10% më pak** shërbimet publike se sa zona urbane, dhe kryesisht të lidhura me tokën, ndihmën ekonomike dhe gjendjen civile.



Zonat rurale identifikojnë **shëndetësinë** si shërbimin publik më pak të përdorur, **20% më pak** se sa zona urbane.



- shërbimet e tjera publike sidomos ato të lidhura me financimet/kreditë janë pak të njohura dhe të përdorura (**22% në qytet dhe rreth 7% në zonat rurale**)

Shërbimet publike të lidhura me financimin dhe kredinë janë pak të njohura dhe të përdorura.





BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



- Nga shërbimet publike kërkohet nga qytetarët më shumë investim në: **infrastrukturë fizike, të burimeve njerëzore dhe orare më fleksibël** për qytetarët, sidomos nga zonat rurale.
- **2:1** është raporti i përdorimit të shërbimeve të bashkisë krahasuar me NJQV-të. Kjo lidhet me ofrimin e shërbimeve më të shumta në Bashki, shkurtimin e procedurave dhe kohës. *90% e të anketuarve të qytetit të Pukës dhe 88% e gjithë të anketuarve përdorin shërbimet e Bashkisë. 74% e të anketuarve të NJQV –ve përdorin shërbimet e NJQV-ve, ose 42% e të gjithë të anketuarve.*



- raporti i përdorimit të shërbimeve të **bashkisë** krahasuar me **njësitë administrative**. (Kjo lidhet me ofrimin e shërbimeve më të shumta në Bashki, shkurtimin e procedurave dhe kohës.)

- raporti i vlerësimit pozitiv të qytetarëve ndaj shërbimeve publike të ofruara nga **bashkia** krahasuar me ato të ofruara nga **njësitë administrative**

Sondazh	Vlerësimi i përgjithshëm	Përqindja
Ka/nuk ka shërbim	Ka	90%
Orari	i përshtatshëm	85%
Pritja	i mirë	80%
Informacioni	i mirë	70%
Cilësia e shërbimit	i mirë - disi	60%
Infrastruktura	i dobët	70%



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



## Të dhënat tabelare sipas sektorit dhe zonës:

BASHKIA/NJQVL	Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
shume mire / mire	80%	39%	38%	36%	38%
disi	10%	26%	23%	27%	25%
jo mire / keq	6%	9%	8%	9%	19%
pa pergjigje	4%	26%	31%	27%	19%
	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Zyra punes	Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
shume mire / mire	62%	43%	38%	36%	38%
disi	19%	22%	15%	18%	31%
jo mire / keq	3%	9%	8%	14%	25%
pa pergjigje	16%	26%	38%	32%	6%
	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Gjendja civile	Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
shume mire / mire	86%	65%	62%	59%	38%
disi	14%	13%	15%	9%	31%
jo mire / keq	0%	13%	8%	5%	31%
pa pergjigje	0%	9%	15%	27%	0%
	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

Shendetsia	Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
shume mire / mire	66%	43%	54%	45%	38%
disi	22%	22%	31%	23%	19%
jo mire / keq	13%	13%	15%	18%	25%
pa pergjigje	0%	22%	0%	14%	19%
	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI




Arsimi		Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
	shume mire / mire	63%	48%	54%	41%	38%
	disi	19%	26%	8%	18%	19%
	jo mire / keq	5%	22%	23%	27%	44%
	pa pergjigje	13%	4%	15%	14%	0%
		<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

transport		Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
	shume mire / mire	62%	26%	31%	27%	19%
	disi	22%	52%	46%	41%	19%
	jo mire / keq	16%	22%	23%	32%	63%
	pa pergjigje	0%	0%	0%	0%	0%
		<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>


Furnizimi me uje		Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
	shume mire / mire	87%	13%	23%	32%	19%
	disi	8%	43%	46%	36%	25%
	jo mire / keq	5%	43%	31%	32%	56%
	pa pergjigje	0%	0%	0%	0%	0%
		<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

energjia		Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
	shume mire / mire	57%	26%	38%	23%	6%
	disi	10%	30%	31%	32%	19%
	jo mire / keq	33%	43%	31%	45%	75%
	pa pergjigje	0%	0%	0%	0%	0%
		<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>



Pastrimi		Puke	Luf Qerret	Rrape	Qelez	Gjegjan
	shume mire / mire	62%	26%		23%	27%
	disi	22%	26%		38%	27%
	jo mire / keq	16%	48%		38%	45%
	pa pergjigje	0%	0%		0%	0%
		100%	100%		100%	100%


**Niveli i vlerësimit pozitiv qytetar ndaj shërbimeve publike sipas njësive administrative/qytet dhe niveli mesatar për Bashkinë Pukë.**







BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI





BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



## PËRFUNDIME / GJETJE DHE REKOMANDIME

- Sa më larg qytetit në drejtim të zonave rurale, aq më shumë theksohen problematikat e aksesit të shërbimeve publike
- Sa më larg qytetit në drejtim të zonave rurale, aq më shumë theksohet nevoja për ndërhyrje institucionale në drejtim të shërbimeve publike si: transport, pastrim, ndriçim, furnizim me ujë dhe investime publike
- Zonat rurale përdorin më pak shërbimet publike se sa zonat urbane, dhe kryesisht të lidhura me tokën, ndihmën ekonomike dhe gjendjen civile.
- Njohja e institucioneve publike dhe informacioni se ku duhet të drejtohen për rastet ankimore është më e madhe në zonën urbane dhe më e vogël në zonat rurale.
- Sipas sondazhit qytetar, niveli i përgjithshëm i ofrimit të shërbimeve publike është i kënaqshëm, por ka vend për përmirësim nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve të shërbimeve publike, jo vetëm për rritjen profesionale, por edhe mbi marrëdhëniet, etikën dhe komunikimin me qytetarët.
- Sipas sondazhit qytetar, më shumë investime kërkohen në drejtim të rritjes së cilësisë së jetës, si shërbime sportive dhe kulturore.
- Sipas sondazhit qytetar kërkohet investim në infrastrukturë fizike, të burimeve njerëzore dhe në orare më fleksibël për qytetarët, sidomos nga zonat rurale.
- Kërkohet hapja e atyre shërbimeve publike që përdorin burimet natyrore, kulturore,





BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



njerëzore të Pukës dhe që nxisin dinamikën e ekonomisë vendore si: shërbime publike që promovojnë turizmin dhe traditën, pyjet dhe qendrat shëndetësore kurative, etj.

### **Sugjerimi i qytetarëve**

- Trajnim të punonjësve të shërbimeve publike
- Shtim të shërbimeve (sidomos shëndetësore) dhe të tregjeve (markatave)
- Kontroll dhe monitorim të cilësisë së shërbimeve nga Bashkia
- Investim për rrugët, transport, kosha mbeturinash, ndriçim
- Më shumë shërbime publike në zonat administrative

**Përmbledhje të Rekomandimeve dhe gjetjeve të diskutuara gjatë validimit, si dhe konkluzione të arritura gjatë diskutimit të tyre me Bashkinë Pukë:**

- **Shërbimi shëndetësor**
  - Marrja e masave për ofrimin e specialiteteve në fushën e mjekësisë, si: okulist, kardiolog, fizioterapist, pediatër etj,
  - Shtimi i numrit të mjekëve me mjekë të rinj duke patur parasysh se mjekët ekzistues janë në prag pensioni.
  - Mbulimi kohor i shërbimit shëndetësor sidomos në zonat rurale të paktën me 12 orë.
  - Marrja e masave për urgjencat shëndetësore dhe mbulimin në kohë dhe territor me autoambulanca.
  - Të llobohet për hapjen e farmacive; vendosjes së shërbimit të kartave shëndetësore pranë njësive administrative



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



**Shënim:** Në përputhje me rekomandimet për shërbimet shëndetësore, bashkia Pukë ka në proces marrjen e masave për 5 mjekë specialistë, si dhe dakortësoi nevojën për përmirësimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor nëpërmjet koordinimit më të mirë me Njësitë Administrative dhe kryepleqtë e caktuar.

- **Pastrimi, Energjia, furnizimi me ujë dhe Transporti**

- Marrja e masave për largimin e mbeturinave si problematikë shqetësuese në Njësitë Administrative
- Marrja e masave për ujësjellës, kanalet vaditëse në Njësitë Administrative
- Marrja e masave për mbifaturimin e energjisë elektrike
- Të llobohet për rehabilitimin e rrjetit energjetik
- Të merren masa për subvencionimin e transportit për fëmijët e njësive administrative që ndjekin shkollën në Pukë, sidomos për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Të merren masa për rehabilitimin e rrugëve që lidhin Njësitë Administrative me qytetin e Pukës
- Të merren masa për rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe depove të ujit.
- Të merren masa për sigurimin e transportit në përgjithësi dhe unifikimit të biletës së transportit sipas largësisë.

**Shënim:** Në përputhje me shqetësimet e ngritura dhe gjetjet, si dhe rekomandimet e ngritura, u dakortësua me Bashkinë Pukë që të vendosen makina për largimin e mbeturinave sipas një plani kohor (1 herë / javë) për çdo njësi administrative. Bashkia Pukë ka në proces rehabilitimin e rrugës dhe të qendrës Gjeggjan, rehabilitimin e kanalit vaditës Luf-Qerret, rehabilitimin e segmenteve rrugore të dëmtuara nga moti i keq, si: rrugë, ura etj. Gjithashtu po llobohet nga Bashkia Pukë në lidhje me transportin në shkolla me kompanitë e transportit. Në lidhje me mbifaturimin e energjisë dhe furnizimit



BASHKIMI EVROPIAN  
DELEGACIONI NË SHQIPËRI



me ujë, u dakortësua marrja e masave për sistemim, duke vendosur sahatet respektivë matës dhe monitorimi i faturimit përkatës.

- **Mirëqeverisja, transparenca dhe zhvillimi i zonave**

- të merren masa për dhënien e informacionit jo vetëm nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë Pukë, por edhe në mënyra tradicionale nëpërmjet afishimit, takimeve komunitare
- të përmirësohet koordinimi mes institucioneve/njësive administrative dhe bashkisë Pukë
- të lobohet për vendosjen e bankomateve edhe në njësitë administrative
- të merren masa për trajnimin e punonjësve të institucioneve për të qënë më kompetent në zgjidhjen e problemeve, jo thjesht në delegim të tyre.
- të merren masa për hapjen e ditëve të pazarit (një herë në javë në secilën njësi administrative)

**Shënim:** U dakortësua që të nxitet pjesëmarrja qytetare në mbledhjet e këshillit bashkiak për temat sipas rendit. U dakortësua që të bëhen takime komunitare në Qendrën për Zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen” sipas temave të caktuara nga grupi “Boria” në lidhje me problematikat e komunitetit në të gjitha njësitë administrative dhe të gjenden mundësi për lobim të përbashkët në rritjen e cilësisë dhe të mbulimit territorial të shërbimeve të caktuara.